



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 korrik 2022
Nr.ref.: RK 2022/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr.KI119/21

Parashtrues

Ahmet Hoti dhe të tjerët

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës Së
Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-1-17-0048 të 11 marsit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ahmet Hoti, Gani Hoti, Bajram Hoti, Elmi Hoti, Fehmi Hoti, Sokol Hoti, Musli Hoti, Vehbi Hoti, Ukshin Hoti, Kadri Hoti, Smajl Hoti, Xhevat Hoti, dhe Nexhat Hoti nga Klina, të përfaqësuar nga avokati Albert Islami nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin [AC-1-17-0048] e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të 11 marsit 2021 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit të DHPGJS) në lidhje me Aktgjykimin [SCC-11-0289] të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të 24 janarit 2017 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar i DHPGJS).
3. Parashtruesit e kërkesës Aktgjykimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së e kanë pranuar më 15 mars 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, përmes së cilit pretendohet se parashtrueseve të kërkesës u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe neni 1 i Protokollit 1 (Mbrotjtja e pronës) dhe 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
5. Përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës gjithashtu ka kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore, ku nga Gjykata kërkon *“të më thërras për të më mundësuar të marrë pjesë dhe për të shqyrtuar në seancën dëgjimore”*.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 29 qershor 2021, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 29 korrik 2021, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin.
9. Më 8 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzie Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban, anëtarë.
10. Më 13 korrik 2021, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë dokumente shtesë.
11. Më 14 korrik 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesve të kërkesës për regjistrimin e kërkesës, dhe kërkoj nga ai që të plotësojë kërkesën me informata shtesë.
12. Më 26 korrik 2021, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës dorëzoi në Gjykatë informatat e kërkuara.

13. Më 28 tetor 2021, Gjykata i dërgoi një shkresë përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës dhe kërkoi informata shtesë lidhur me parashtruesit Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti, se në çfarë cilësie paraqiten para Gjykatës.
14. Më 3 nëntor 2021, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës dorëzoi në Gjykatë informatat e kërkuara, ku ndër të tjera theksoi se parashtruesit e kërkesës Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti *“paraqiten ne cilësinë e bashkë ndërgjyqësve unike material-sukcesore juridik te babait te tyre Emin Mehmet Hotit, ish nga fshati Resnik, Komuna e Klinës, i cili ka ndërruar jete me 14.02.2021 e i cili ka qenë njëri ndër bashkë ndërgjyqësit unike material gjatë procedurës se zhvilluar juridike-kontestimore ne Dhomën e Posaçme te Gjykatës Supreme te Kosovës ne periudhën e kaluar”*.
15. Më 20 janar 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe vendosi që rasti të shtyhet në një nga seancat e ardhshme.
16. Më 22 qershor 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

17. Sipas parashtruesve të kërkesës, me 14 prill 1959, Këshilli Popullor Komunal Dobra Voda nëpërmjet aktvendimit [nr.01-920/1-1959], kishte konfiskuar paluajtshmëritë në sipërfaqe prej 110.84.95 ha dhe 19.80.33 ha nga ana e paraardhësit të tyre R.S.H, dhe të cilat ia kishte kaluar ndërmarrjes bujqësore “Malishgani” nga Klina. Konfiskimi ishte bërë edhe ndaj paluajtshmërive të vëllezërve dhe pasardhësve të tij: Ahmet Xhemë Hotit nga fshati Resnik, Komuna e Klinës, sipërfaqja prej 22.90.06 ha sipas FP 117, zona kadastrale Dush, (2) Enver Sadri Hoti dhe Rexhep Sadri Hoti, suksesorë dhe trashëgimtarë te Sadri Rexhep Hotit nga fshati Resnik, Komuna e Klinës për një sipërfaqe prej 06.11.10 ha e regjistruar ne FP 115, ZK Dusheviq, (3) Emin Mehmet Hoti dhe Gani Mehmet Hoti suksesorë dhe trashëgimtarë te Mehmet Rexhep Hotit nga fshati Resnik, Komuna e Klinës për një sipërfaqe prej 06.83.82 ha e regjistruar ne FP 114, ZK Dusheviq (4) Fehmi Muje Hoti, Elmi Muje Hoti, Bajram Muje Hoti, Musli Halil Hoti, Sokol Halil Hoti dhe Vehbi Halil Hoti suksesorë dhe trashëgimtarë te Gjyle Musli Hoti nga fshati Resnik, Komuna e Klinës për një sipërfaqe prej 24.47.86 ha, e regjistruar ne FP 116 e vitit 1959, ZK Dusheviq, (5) Ukshin Haxhi Hoti, Smajl Haxhi Hoti dhe Kadri Haxhi Hoti nga fshati Resnik, Komuna e Klinës, trashëgimtarë juridike i Hyre Adem Hotit ne sipërfaqe prej 20.55.34 ha ZK Dush, e regjistruar ne FP 118, ZK Dush. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se që nga viti 1999 janë *“në posedim dhe kanë punuar dhe janë kujdesur për këto prona”*.
18. Në vitin 2011, parashtruesit e kërkesës Ahmet Hoti, Gani Hoti, Bajram Hoti, Elmi Hoti, Fehmi Hoti, Sokol Hoti, Musli Hoti, Vehbi Hoti, Ukshin Hoti, Kadri Hoti, Smajl Hoti, Emin Hoti i cili para Gjykatës përfaqësohet nga djemtë e tij Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti, si dhe R.S.H, E.S.H dhe V. M.H, (të cilët nuk janë parashtrues para Gjykatës), parashtruan padi pranë Kolegjit të Specializuar të DHPGJS kundër Ndërmarrjes Bujqësore NSH. NPB “Malishgani” nga Klina e cila ishte nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), përmes të cilës kërkuan vërtetimin e te drejtës se pronësisë dhe dorëzimin ne posedim te patundshmërisë për shkakun se *“kjo toke ishte marre prej tyre (Paditesi 3 (Ahmet Hoti)) ose paraardhësit e tyre ligjor, respektivisht, ne vitin 1959 ne te mire te NSH Malishgan”*.
19. AKP si përfaqësuese e NSH NPB “Malishgani” kishte kontestuar legjitimitetin aktiv dhe meritat e padisë.

20. Më 19 nëntor 2013, parashtruesit e kërkesës Ahmet Hoti, Gani Hoti, Bajram Hoti, Elmi Hoti, Fehmi Hoti, Sokol Hoti, Musli Hoti, Vehbi Hoti, Ukshin Hoti, Kadri Hoti, Smajl Hoti, Emin Hoti i cili para Gjykatës përfaqësohet nga djemtë e tij Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti, si dhe R.H, E.H dhe V.H (të cilët nuk janë parashtrues para Gjykatës), parashtruan kërkesë për lëshimin e masës së përkohshme e cila do të parandalonte AKP-në të privatizojë, tjetërsojë apo ngarkojë pronën që ishte objekt i shqyrtimit.
21. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së përmes Aktvendimit [SCC-11-0289] kishte refuzuar kërkesën për caktimin e masës së sigurisë me arsyetimin se *“nuk janë plotësuar kushtet e nenit 55.1 të shtojcës së Ligjit 04/L-033”*.
22. Më 24 janar 2017, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, përmes Aktgjykimit [SCC-11-0289] padinë e parashtruesve të kërkesës e hodhi poshtë si të papranueshme për mungesë të legjitimitetit të tyre aktiv. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, përmes Aktgjykimit kishte arsyetuar se parashtruesit *“nuk kanë ofruar prova për trashëgiminë e tyre,”* ndërsa padinë e parashtruesit Ahmet Hoti, e refuzoi si të pabazuar me arsyetim se *“nuk ishte përcaktuar sakte vendndodhjen e patundshmërisë dhe se nuk ishte parashtruar asnjë pretendim se shpronësimi kishte ndodhur me force”*.
23. Në një datë të pasaktësuar parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Në ankesën e tyre parashtruesit e kërkesës theksuan se *“Aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje thelbësore nga neni 10 par. 4 i LDHP dhe neni 160 par. 3 i LPK-së, diapozitivi së bashku me arsyetimin nuk janë të qarta si dhe nuk janë administruar provat e paraqitura nga paditësit. Gjithashtu ankuesit pohuan se nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike sikurse edhe raporti i ekspertit, revizioni kadastral i vitit 1948, reambulimi i kadastrit i vitit 1956, aktvendimi 01-920/1-1959 i datës 19 prill 1959 si dhe posedimi me mirëbesim që nga viti 1994”*.
24. Më 11 mars 2021, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së përmes Aktgjykimit [AC-I-17-0048] refuzoi ankesën e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, SCC-11-0289 të 24 janarit 2017. Kolegji i Apelit në Aktgjykimin e tij ndër të tjera theksoi *“[...] Në këtë lëndë Kolegji i Apelit vëren se paditësit nuk kanë rregulluar çështjen e trashëgimisë. Paditësit i është dhënë mundësia nga ana e gjykatës, përmes ne seancën dëgjimore të datës, 14/11/2016 të dërgojë Aktvendimin e trashëgimisë për të vërtetuar legjitimitetin e tyre aktiv, mirëpo kane dështuar ta dorëzojnë këtë dokument. Kolegji i Apelit vlerëson se Aktvendimi Trashëgimisë është i vetmi dokument ne baze të nenit 171.1 lidhur me. nenin 178.1 të Ligjit për procedurën jo kontestimore, i cili e vërteton legjitimitetin e aktiv ne procedurë. Ne baze të arsyeve të cekura ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet, Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar ne ligj. Lidhur me paditësin nr. 3, Kolegji i Apelit konsideron se ne baze të nenit 42.3 të Ligjit, palët kane për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të provoj faktet e pohuara, për ti mbështetur pretendimet e veta. [...] Paditësi ka dështuar të sjellë shpjegime apo prova për të kundërshtuar vlefshmërinë ligjore të bazës mbi të cilën në vitin 1959, prona e pretenduar sipas historiatit të pronës nr.04/1986 të datës 30/04/2002 të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Klinë ka kaluar në emër të NSH-së [...]”*.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

25. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin [AC-I-17-0048] e 11 marsit 2021 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, me pretendimin se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 1 i Protokollit 1 (Mbrotjtja e pronës) dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
26. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës, në esencë, theksojnë se: (i) gjykatat nuk kanë administruar të gjitha provat e propozuara nga përfaqësuesi i tyre, dhe (ii) gjykatat nuk kanë dhënë arsye lidhur me refuzimin e administrimit të tyre, si dhe (iii) nuk është marrë për bazë propozimi i përfaqësuesit lidhur me dëgjimin e palëve dhe dëshmitarëve, dhe për pasojë, sipas parashtruesve *“Është i pabazuar dhe i papranueshëm konstatimi i theksuar ne aktgjykimin e shkallës së parë dhe aktgjykimin e shkallës së dytë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme se procedura e provave nuk ka funksionuar për të përcaktuar se çka është e drejte, se çka është e gabuar lidhur me pretendimet e theksuara rreth fakteve relevante. Kjo ngase Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme nuk ka marrë aktvendim për të administruar provat juridikisht të vlefshme, të propozuara nga përfaqësuesi i paditësve e as që ka dhënë arsye lidhur me refuzimin e administrimit të tyre”*.
27. Lidhur me këtë parashtruesit e kërkesës pohojnë se *“duke i propozuar provat qofte ato shkresore apo edhe me dëgjimin e dëshmitarëve, ka vërtetuar pretendimet e tij që se pari me aktvendimin e theksuar R.S. H., paraardhësit të paditësve i është konfiskuar prona e paluajtshme mbi 130 ha si rezultat i pushtetit të tij nga pushteti komunist jugosllav në vitin 1944. Këto prona të paluajtshme kanë qene në pronësi të paraardhësit të paditësve. Përfaqësuesi i paditësve i ka paraqitur të gjitha provat e theksuara që vërtetojnë faktet vendimtare se pronar i vetëm dhe i ligjshëm ka qene R. S. H. dhe pasardhësit e tij”*.
28. Tutje parashtruesit e kërkesës theksojnë se *“Aktgjykimi i kundërshtuar është marrë me shkelje të garancive kushtetuese nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore. Kjo ngase përfaqësuesit të paditësve ia pamundëson që në seance të shqyrtoje të gjitha çështjet kontestuese lidhur me vërtetimin e pronës së paluajtshme të pretenduar duke ia pamundësuar të beje pyetje dëshmitarëve të propozuar nga i njëjti”. Ata më tej potencojnë se “ndonëse paditësit bashkëngjitur padisë dhe plotësimit të padisë i kanë propozuar gjykatës që të administrohen provat juridikisht të vlefshme për të vërtetuar faktet relevante për vërtetimin e pronësisë mbi pronat e paluajtshme të tyre dhe paraardhësve të tyre edhe atë: (i) konstatimin dhe mendimin e ekspertit të gjeodezisë nr. 04-56 i dt. 30.04.2002, (ii) revizionin e kadastrit të vitit 1948, (iii) reambulimin e kadastrit për fletën poseduese 45, Komuna Kadastrale Dush e vitit 1956, dhe (iv) aktvendimin e këshillit popullor komunal Dobra Voda nr. 01-920/1-1959 i dt. 14.04.1959 me të cilin, Rexhep Sadri Hoti është shpallur armik i pushtetit popullor i konfiskohet në mënyrë arbitrare prona e paluajtshme në sipërfaqe prej 110.84.95 ha dhe sipërfaqja prej 19.80.33 ha nga pushteti komunist jugosllav duke e ekzekutuar të njëjtin me pushtet në vitin 1944. Pasardhësit e tij janë Ahmet Hoti, Enver Hoti, Gani Hoti e të tjerët”. Prandaj, sipas parashtruesve konstatimi i aktgjykimit të kundërshtuar “është arbitrar dhe abuziv kur theksohet se paraardhësit e paditësve kanë dorëzuar vullnetarisht pronat e paluajtshme që janë objekt i kërkesës dhe se nuk është vërtetuar se janë dorëzuar me kërcënim dhe forcë. Me një konstatim të tillë është cenuar garancia kushtetuese nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës për një gjykim të drejte dhe të rregullt”. Sipas tyre për këto*

pretendime, gjykata nuk ka administruar asnjë prove dhe nuk ka vërtetuar asnjë fakt juridikisht të vlefshëm për mundësinë e dorëzimit vullnetar të pronave të tyre të paluajtshme pushtetit të atëhershëm jugosllav.

29. Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së parashtruesit e kërkesës ndër të tjera pretendojnë se përfaqësuesi i tyre “me vendosmëri dhe këmbëngulësi i ka propozuar sikundër provat shkresore ashtu edhe dëgjimin e dëshmitareve për ti vërtetuar-provuar pretendimet e tij se prona që është objekt i kërkesës është marre me konfiskim dhe se të njëjtit janë privuar nga e drejta e kësaj prone të paluajtshme me dhunën e instrumentalizuar nga pushteti komunist jugosllavë”. Lidhur me këtë ata theksojnë se konfiskimi i pronave të paluajtshme të tyre qartazi dhe në mënyrë ekskluzive është në kundërshtim me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.
30. Parashtruesit po ashtu theksojnë se “te gjitha shtetet që kanë dale nga ish Jugosllavia, duke filluar nga viti 1992 i kanë miratuar dhe tashme implementuar ligjet për restituimin e pronave të paluajtshme të konfiskuara, nacionalizuara, sekuestruara apo mbi bazën e reformës agrare. Në baze të këtyre dispozitave ligjore këto shtete e kanë përfunduar dhe përmbyllur procesin e kthimit të ligjshëm dhe të drejte të pronave të paluajtshme pronareve të tyre të mëparshëm apo pasardhësve apo trashëgimtarëve të tyre. Duke qene se sipas dispozitës së nenit 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (neni 1, protokollin 1) zbatohet drejtpërsëdrejti duke pasur përparësi dhe, në rast të konfliktit, ka epërsi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera në Republikën e Kosovës, atëherë, pikërisht mbi këtë baze kushtetuese kërkojmë që Ahmet Hotit dhe paditësve tjerë - suksesorëve t’iu behet restituimi i pronave të konfiskuara me shkelje të konventës së theksuar”.
31. Më tej parashtruesit theksojnë se “është i natyrës arbitrare dhe abuzive konstatimi i aktgjykimit të gjykatës se shkalles se pare se prona e pretenduar është prone shoqërore, pa e konkretizuar, pa administruar asnjë prove dhe pa shqyrtuar asnjë fakt se ku gjendet ajo prone, sipërfaqe, vendndodhje dhe elementet e tjera të përkufizimeve dhe matjeve gjeometrike”. Në baze të kësaj, sipas parashtruesve në këtë rast “Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme me aktgjykimet e kundërshtuara, në tërësinë e tyre nuk ka siguruar parashtruesve të kërkesës një gjykimin fer, korrekt, të paanshëm, të barabartë për të gjitha palët ndërgjyqëse”.
32. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë shkelje të nenit 24 të Kushtetutës. Përkitazi me këtë pretendim, i referohen përmbajtjes së nenit, duke mos specifikuar pretendimet e tyre.
33. Në fund, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës nga Gjykata kërkon “ të më thërras për të më mundësuar të marrë pjesë dhe për të shqyrtuar në seancën dëgjimore”.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj
(...)

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

LIGJI Nr. 03/L-007 PËR PROCEDURËN JOKONTESTIMORE

Aktvendimi për trashëgimin Neni 171

171.1 Kur gjykata në procedurën trashëgimore konstaton se cilëve persona u takon e drejta për trashëgim, do t'i shpall këta persona trashëgimtarë me anë të aktvendimit të vet për trashëgim.

Neni 178

178.1 Konsiderohet se me anë të aktvendimit për trashëgimin që ka marrë formë të prerë është konstatuar se çka hynë në pasurinë trashëgimore, se kush është trashëgimtar i të vdekurit, sa është e madhe pjesa e pasurisë që i takon, se a i është kufizuar apo ngarkuar e drejta e trashëgimit dhe në cilën mënyrë, si dhe se a ekzistojnë dhe cilat të drejta të legatit ekzistojnë. E gjithë kjo vlen edhe për aktvendimin e pjesshëm për trashëgim në pikëpamje të asaj që është konstatuar me anë të tij.

LIGJI NR. 06/L-086 PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 42 Rregullat e përgjithshme mbi provat

3. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë. Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

36. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kane përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individë mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49 (Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

37. Fillimisht, Gjykata, nga shkresat e lendes, vëren se parashtrues të kërkesës janë: Ahmet Hoti, Gani Hoti, Bajram Hoti, Elmi Hoti, Fehmi Hoti, Sokol Hoti, Musli Hoti, Vehbi Hoti, Ukshin Hoti, Kadri Hoti, Smajl Hoti, Xhevat Hoti, dhe Nexhat Hoti nga Klina, të përfaqësuar nga avokati Albert Islami nga Prishtina. Gjykata vëren se Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti nuk ishin pale pranë gjykatave të rregullta por ishte babai i tyre Emin Mehmet Hoti tani me i ndjere. Në shkresën e dërguar nga Gjykata më 28 tetor 2021, përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës duke kërkuar informata shpesh lidhur me parashtruesit Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti, se në çfarë cilësie paraqiten para Gjykatës, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës ndër të tjera theksoi se parashtruesit e kërkesës në fjalë "paraqiten në cilësinë e bashkë ndërgjyqësve unike material- suksore juridik të babait të tyre Emin Mehmet Hotit, ish nga fshati

Resnik, Komuna e Klinës, i cili ka ndërruar jete me 14.02.2021 e i cili ka qenë njëri ndër bashkë ndërgjyqësit.”

38. Bazuar në si me sipër, Gjykata thekson se si çështje parësore e pranueshmerise qe duhet te konsiderohet ne këtë rast konkret, është fakti se a janë parashtruesit Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti pale e autorizuar siç kërkohet me paragrafët 1 dhe 7 te nenit 113 te Kushtetutës - te cituar me lart. Ne vijim Gjykata do te shqyrtoj ndaras plotësimin e kriterëve te palës se autorizuar respektivisht pranueshmerisë se kërkesës se parashtruesve (i) Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti, dhe (ii) Ahmet Hoti, Gani Hoti, Bajram Hoti, Elmi Hoti, Fehmi Hoti, Sokol Hoti, Musli Hoti, Vehbi Hoti, Ukshin Hoti, Kadri Hoti, Smajl Hoti.

(i) Sa i përket parashtruesve Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti

39. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme nga ana e parashtruesve të kërkesës Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti përkatësisht nëse këta janë palë e autorizuar pranë Gjykatës, Gjykata duke u bazuar në dispozitat e lartcituara të Kushtetutës dhe Ligjit, duhet të vlerësohet në kuptim të “statusit të viktimës” të parashtruesve të kërkesës.
40. Ne këtë aspekt, është e ditur se para kësaj Gjykate mund te paraqiten individët te cilët pretendojnë te jene viktimat direkte te shkeljeve te mundshme te Kushtetutës apo te instrumenteve te tjera ndërkombëtare qe mbrojnë te drejtat dhe liritë e njeriut. Po ashtu, praktika gjyqësore e kësaj Gjykate tregon se, ne raste te caktuara, edhe viktimat indirekte apo te tërthorta mund te pranohen si pale te autorizuar (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me nenin 25 te Kushtetutës ne lidhje me nenin 2 te KEDNJ-se, KI41/12, Gëzim dhe Makfire Kastrati, Aktgjykim i 26 shkurtit 2013).
41. Me qellim te përcaktimit te statusit te viktimës për parashtruesit e kërkesës, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore te GJEDNJ-se, ku parashihen rastet për te cilat një viktimit indirekte apo e tërthorte mund te paraqitet para saj dhe te legjitimohet si pale e autorizuar. Përgjithësisht, deri me sot, GJEDNJ iu ka pranuar statusin e viktimës indirekte apo te tërthorte vetëm familjareve te ngushte apo personave te afërm ("next-of-kin"), te cilët kane arritur te dëshmojnë se kane interes te rëndësishëm mbi çështjen e personit te ndjere me te cilin ata kane qene te lidhur.
42. Statusi i viktimës indirekte apo te tërthorte, ne mënyre te vazhdueshme iu akordohet personave te cilët ngrenë pretendime rreth vdekjes apo zhdukjes se personit te tyre te afërm (shih rastin e GJEDNJ: Varnava dhe te tjerët kundër Turqise, kërkesat nr. 16-64/90 dhe 8 te tjera, Aktgjykim i 18 shtatorit 2009, paragrafi 112). Kjo qasje e GJEDNJ-se është arsyetuar me faktin qe neni 2 i KEDNJ-se është njëra nga dispozitat me fundamentale te te gjithë sistemit mbrojtës te KEDNJ-se (shih rastin e GJEDNJ: Fairfield kunder Mbretërisë se Bashkuar, kërkesa nr. 24790/04, Aktgjykim i 8 marsit 2005). Për nenin 2 te KEDNJ-se, GJEDNJ i ka pranuar si viktimat indirekte apo te tërthorta anëtarët e ngushte te familjes, e posaçërisht rastet qe lidheshin me obligimin pozitiv te shtetit për te mbrojtur te drejtën e tyre te përcaktuar me nenin 2 te KEDNJ-se (shih rastet e GJEDNJ-se: Van Colle kundër Mbretërisë se Bashkuar, kërkesa nr. 7678/09, Aktgjykim i 13 nëntorit 2012, paragrafi 86; dhe Tsalikidis dhe te tjerët kundër Greqisë, kërkesa nr. 73974/14, Aktgjykim i 16 nëntorit 2017, paragrafi 64).
43. Te afërmit e te ndjerit, si viktimat te tërthorta apo indirekte, munden po ashtu te paraqesin ankesa bazuar ne nenin 3 dhe 5 te KEDNJ-se - ne emër te personit te vdekur apo te zhdukur ne rast se pretendimi për shkelje është ngushtësisht i lidhur me vdekjen apo zhdukjen dhe si i tille ngrite çështje te mbrojtura me nenin 2 te KEDNJ-se

(shih rastin e GJEDNJ-se: Khayrullina kundër Rusisë, kërkesa nr. 29729/09, Aktgjykim i 19 dhjetorit 2017, paragrafët 91-92 dhe 100- 107).

44. GJEDNJ iu ka njohur këtë status ish-bashkëshorteve (shih rastet: McCann dhe te tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesat nr. 18984/91 dhe te tjerat me radhe, Aktgjykim i 27 shtator 1995); partnereve te pamartuar (shih rastin: Velikova kundër Bullgarisë, kërkesa nr. 41488/98, Aktgjykim i 18 majit 2000); prindërve (shih rastin: Ramsahai dhe te tjeret kunder Holandes, kërkesa nr. 52391/99, Aktgjykim i 15 majit 2007); motrave apo vëllezërve (shih rastin: Andronicou dhe Constannnou kunder Qipros, kërkesa nr. 25052/94, Aktgjykim i 9 tetorit 1997); fëmijëve (shih rastin: McKerr kunder Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 28883/95, Aktgjykim i 4 majit 2001); nipërve dhe mbesave (shih rastin: Yaşa kundër Turqisë, kërkesa nr. 22495/93, Aktgjykim i 2 shtatorit 1998). 53.
45. Gjykata, ne lidhje me këto raste, vëren se asnjëri prej tyre nuk ka te beje me te drejtën për një gjykim te drejte dhe te paanshëm te garantuar me nenin 6 te KEDNJ-se dhe nenin 1 te Protokollit nr. 1 te KEDNJ-se. Ne fakt, rastet te cilat nuk ishin ngushtësisht te lidhura me "vdekjen" apo "zhdukjen" e viktimës direkte, GJEDNJ ka aplikuar një qasje shume me restriktive (shih rastin: Karpynenko kunder Ukraines, kërkesa nr. 15509/12, Aktgjykim i 11 shkurtit 2016, paragrafi 104). 54. Ne lidhje me ankesat ne baze te nenit 6, GJEDNJ ka qene e gatshme t'i njohe një te afërmi te drejtën e locus standi, ose kur ankesat kane qene te një interesi te përgjithshëm dhe ankuesit, si trashëgimtare, kane pasur interes legjitim për ndjekjen e kërkesës (shih rastet Marie-Louise Loyen dhe Bruneel kundër Frances, nr. 55929/00, paragrafi 29, Aktgjykim i 5 korrikut 2005, dhe Bic dhe te tjerët kundër Turqisë, kërkesa nr. 55955/00, paragrafi 23, Aktgjykim i 2 shkurtit 2006), ose ne baze te efektit te drejtpërdrejte mbi te drejtat trashëgimore te kërkuarit (shih rastin: Ressegatti kunder Zvices, kërkesa nr. 17671/02, paragrafi 25, Aktgjykimi i 13 korrikut 2006).
46. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret parashtruesit *Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti* janë të bijtë e *Emin Mehmet Hotit* të cilët parashtrojnë kërkesë në Gjykatë. Vdekja e të ndjerit *Emin Mehmet Hotit* është vdekje natyrale. Procedurat gjyqësore pranë gjykatave të rregullta në fakt kanë filluar dhe janë udhëhequr nga i ndjeri *Emin Mehmet Hoti*. Thënë këtë, Gjykata ka parasysh që rasti është i ndërlidhur më një kontest civil- pronësor, ku parashtruesit e kërkesës *Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti* si pasardhës të *Emin Mehmet Hotit*, pas vdekjes së babait parashtruan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
47. Gjykata gjithashtu vëren se Aktgjykimit i kontestuar i Kolegjit të Apelit të Dhomës Së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-1-17-0048 ishte nxjerre me 11 mars 2021 nuk ishte cekur fakti se parashtruesi *Emin Mehmet Hoti* kishte ndërruar jete, dhe ne Aktgjykimin e kontestuar emri i te ndjerit figuron si pale paditëse. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës *Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti* nuk ishin pale ne procedure para Kolegjit te Specializuar dhe atij te Apelit te DHPGJS, Aktgjykimin e këtij te fundit, te cilin ne mënyre specifike e kontestojnë para Gjykatës.
48. Gjykata gjithashtu vëren se më 11 mars 2021, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së përmes Aktgjykimit [AC-I-17-0048] refuzoi ankesën e te gjithë parashtruesve të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, SCC-11-0289 të 24 janarit 2017. Kolegji i Apelit në Aktgjykimin e tij ndër të tjera theksoi "[...] Në këtë lëndë Kolegji i Apelit vëren se paditësit nuk kanë rregulluar çështjen e trashëgimisë. Paditësit i është dhënë mundësia nga ana e gjykatës, përmes ne seancën dëgjimore te datës, 14/11/2016 te dërgoje Aktvendimin e trashëgimisë për te vërtetuar legjitimitetin e tyre aktiv, mirëpo kane dështuar ta dorëzojnë këtë dokument. Kolegji i Apelit vlerëson se Aktvendimi Trashëgimisë është i vetmi

dokument ne baze te nenit 171.1 lidhur me. nenin 178.1 te Ligjit për procedurën jo kontestimore, i cili e vërteton legjitimitetin e aktiv ne procedurë. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se Emin Mehmet Hotit (babait te parashtruesve) si edhe parashtruesve te tjerë nuk i ishte njohur legjitimiteti aktiv duke iu refuzuar njohja e te drejtës pronësore mbi pronat e kontestuar.

49. Ne këtë kontekst, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore GJEDNJ-se e cila ka konstatuar se "fjala viktime ne kontekst te nenit 34 te KEDNJ-se nënkupton personin ose personat te afektuan ne mënyre direkte apo indirekte nga shkelje e pretenduar, por edhe viktimën indirekte te cilit shkelja do ti shkaktonte dem ose do te kishte një interes valid apo personal qe kjo shkelje te përfundonte" (shih rastin Vallianatos the te tjeret kunder Greqise [DHM], kërkesa nr. 29381/09 dhe 32684/09, Aktgjykim, i 7 nëntorit 2013, paragrafi 47). Sipas GJEDNJ "nacioni "viktime" është interpretuar ne mënyre autonome dhe pavarësisht nga rregullat vendore sic jane ato te pasurit interes apo mundësinë për te ndërmarre veprime (shih rastin Gorraiz Lizarraga dhe te tjerët kundër 13 Spanjes, kërkesa nr. 62543/00, Aktgjykim, i 27 prilli 2004, paragrafi 35) edhe pse Gjykata duhet te kete parasysh faktin qe parashtruesi ka qene pale ne procedure ne gjykatat vendore "(shih rastin Aksu kunder Turqise [DHM], kërkesa nr. 4149/04 dhe 41029/04, Aktgjykim, i 15 korrikut 2012, paragrafi 52; Micallef kundër Maltës [DHM], kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim, i 15 tetorit 2009, paragrafi 48; Bursa Barosu Baskanligi dhe te tjeret kunder Turqisë, kërkesa nr. 25680/05, Aktgjykim, i 19 qershorit 2018, paragrafët 109-117).
50. Rrjedhimisht, bazuar ne atë si me larte, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti (si dhe parashtruesit tjerë) ne kërkesën e tyre ne thelb kane pretenduar shkelje te nenit 31 te Kushtetutës dhe shkelje te te drejtës se tyre ne prone te garantuar me nenin 46 te Kushtetutës. Ne këtë kontekst, Gjykata rikujton se ne procedurat gjyqësore te përfunduara para gjykatave te rregullta nuk është konstatuar apo vërtetuar se Emin Mehmet Hoti babai i parashtruesve te kërkesës ka qene pronar i pronave te kontestuar.
51. Prandaj, bazuar ne atë si me larte, përkatësisht duke iu referuar praktikës gjyqësore te GJEDNJ-se dhe praktikës se Gjykatës (KI 34/20, parashtrues Ramadan Zogaj, Aktvendim për Papranueshmëri, i 13 nëntor 2020, KI 11/20 Parashtrues Fllanza Pozhegu, Aktvendim për Papranueshmëri, i 18 dhjetor 2020), Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk janë pale e autorizuar ashtu siç përcaktohet me paragrafët 1 dhe 7 te nenit 113 te Kushtetutës dhe rregullit 39 (1) (a) te Rregullores se punës qe te paraqes kërkesë kundër një Aktgjykimi, i cili është nxjerre ne procedure ku parashtruesit kërkesës Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti nuk kane qene pale ne procedure ose përmes se cilës nuk është vendosur lidhur me te drejtat e tyre (shih, mutatis mutandis, rastin e Gjykatës KI74/13, parashtrues Shefqet Hasimi, Aktvendim për Papranueshmëri, i 13 shtatorit 2013, paragrafi 25).
52. Si përfundim, Gjykata ne pajtim me paragrafët 1 dhe 7 te nenit 113 te Kushtetutës dhe rregullit 39 (1) (a) te Rregullores se punës konstaton se parashtruesit e kërkesës Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti nuk janë palë e autorizuar, dhe se kërkesa e tyre nuk i plotëson kriteret e parapara ne nenin 113.1 dhe 113.7 te Kushtetutës, nenin 47 te Ligjit dhe rregullin 39 (1) (a) te Rregullores se punës.

(ii) Sa i përket parashtruesve të kërkesës Ahmet Hoti, Gani Hoti, Bajram Hoti, Elmi Hoti, Fehmi Hoti, Sokol Hoti, Musli Hoti, Vehbi Hoti, Ukshin Hoti, Kadri Hoti, Smajl Hoti

53. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të lartcekura të pranueshmerisë Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës Ahmet Hoti, Gani Hoti, Bajram Hoti, Elmi Hoti, Fehmi Hoti, Sokol Hoti, Musli Hoti, Vehbi Hoti, Ukshin Hoti, Kadri Hoti, Smajl Hoti janë palë e autorizuar, të cilët kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës Së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-1-17-0048 të 11 marsit 2021, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu i kanë qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendojnë se u janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
54. Në vijim Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Më saktësisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

55. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
56. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "qartazi e pabazuar" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "pretendime qartazi të pabazuara". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime "të shkallës së katërt"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes"; (iii) pretendime "të pambështetura apo të paarsyetuara"; dhe në fund, (iv) pretendime "konfuze dhe të paqarta" (shih rastet e GJEDNJ-së, Kemmachev kundër Francës, Aplikimi nr.17621/91, kategoria (i), Mentzen kundër Lituanisë, Aplikimi nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe Trofimchuk kundër Ukrainës, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).
57. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesëve të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

58. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës në thelb pretendojnë : i) shkeljet e të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ii) shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së, dhe iii) shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës.

Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

59. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton që rrethanat e rastit ndërlidhen me një patundshmëri për të cilën parashtruesit e kërkesës pohojnë iu ishte konfiskuar nga ana e pushtetit të atëhershëm jugosllav prej paraardhësit të tyre dhe parashtruesit Ahmet Hoti i cili është akoma në jete. Sipas parashtruesve të kërkesës, më 14 prill 1959, Këshilli Popullor Komunal Dobra Voda nëpërmjet aktvendimit [nr.01-920/1-1959], kishte konfiskuar paluajtshmëritë në sipërfaqe prej 110.84.95 ha dhe 19.80.33 ha nga ana e paraardhësit të tyre R.S.H, dhe të cilat ia kishte kaluar ndërmarrjes bujqësore NSH NPB "Malishgani" nga Klina. Në vitin 2011, parashtruesit e kërkesës kishin parashtruar padi pranë DHPGJS-së kundër AKP-së si administruese e pronave shoqërore, duke kërkuar vërtetimin e te drejtës se pronësisë dhe dorëzimin në posedim të patundshmërive në fjalë. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, padinë e parashtruesve të kërkesës e hodhi poshtë si të papranueshme *"pasi që nuk kishin ofruar prova për trashëgimin e tyre"*, ndërsa padinë e parashtruesit Ahmet Hoti e refuzoi si të pabazuar duke theksuar se parashtruesi *"nuk kishte qenë mjaftueshëm konkret lidhur me vendndodhjen e tokës së pretenduar të shpronësuar nga ai"*. Po ashtu edhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së ku parashtruesit paraqiten ankesë, refuzoi ankesën e tyre si të pabazuar, duke theksuar se *"parashtruesit e kërkesës nuk e kanë rregulluar çështjen e trashëgimisë dhe se Aktvendimi i trashëgimisë është i vetmi dokument në bazë të nenit 171.1 lidhur me nenin 178.1 të Ligjit për Procedurën jo kontestimore, i cili e vërteton legjitimitetin aktiv në procedurë"*. Ndërsa sa i përket parashtruesit Ahmet Hoti, Kolegji i Apelit kishte theksuar se parashtruesi i kërkesës kishte dështuar të sjellë shpjegime dhe prova lidhur me pretendimet e tij, ku ndër të tjera theksoi se *"Lidhur me paditësin nr. 3, Kolegji apelit konsideron se në baze të nenit 42.3 të Ligjit, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat mbështesin kërkesat e veta dhe të provoj faktet e pohuara, për të mbështetur pretendimet e veta"*.
60. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë konstatimin e gjykatave të rregullta para Gjykatës, duke ngritur pretendime që ndërlidhen, në esencë, me garancitë procedurale të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me neni 6 të KEDNJ-së. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës, ndër të tjera, vënë në theks (i) mos administrimin e provave dhe vërtetimin e gabuar të fakteve të cilat ata i kanë paraqitur para gjykatës duke e lidhur këtë edhe (ii) me mos dëgjimin e dëshmitarëve të cilët përfaqësuesi i tyre ia kishte propozuar gjykatës.
61. Në shqyrtimin e këtyre pretendimeve, Gjykata fillimisht thekson se të njëjtat në esencë ndërlidhen me vërtetimin e gabuar të fakteve, pretendime të cilat, Gjykata në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, i konsideron si *"pretendime të shkallës së katërt"*.
62. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së, (shih, në këtë kontekst, sqarimin në Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2022 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2."Shkalla e katërt", paragrafët 289 dhe 305), parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të *"kushtetutshmërisë"* dhe

"ligjshmërisë" dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për atë sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI179/18, parashtrues *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A.*, "*Adem Jashari*", Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues, *Basri Deva*, *Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).

63. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI49/19, cituar më lart, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 61).
64. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, nr.38366/97, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërliidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka "*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*" në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin përkatës. (Për një sqarim më të detajuar përkitazi me konceptin e "*aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*", shih, ndër të tjera, Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së (aspekti civil), të 31 gushtit 2020, pjesën IV. Kriteret Procedurale; 3. Shkalla e Katërt; b. Fushëveprimi dhe Kufizimet e mbikëqyrjes së Gjykatës, paragrafët 329-333; dhe rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).
65. Në këtë kontest, Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, pretendimet kryesore të parashtruesve të kërkesës ndërliidhen me vërtetimin e gabuar të fakteve nga ana e Gjykatave të rregullta. Në esencë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Kolegji i Specializuar dhe ai i Apelit të DHPGJS-së kanë bërë interpretim të gabuar të fakteve dhe se nuk kanë marrë parasysh dëshmitarët e propozuar nga ana e përfaqësuesit të tyre, lidhur me marrjen e informatave për konfiskimin e dhunshëm të pronës dhe vendndodhjen e pronës kontestuese dhe shfrytëzimin e saj nga ana e parashtruesve.
66. Lidhur me parashtruesit Gani Hoti, Bajram Hoti, Elmi Hoti, Fehmi Hoti, Sokol Hoti, Musli Hoti, Vehbi Hoti, Ukshin Hoti, Kadri Hoti, Smajl Hoti, dhe Emin Mehmet Hoti i cili para Gjykatës përfaqësohet nga Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti (te bijtë ti), Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme përmes Aktgjykimit [SCC-11-0289] të 24 janarit 2017, kishte theksuar si në vijim:

“ Paditësit prej numër 5 deri 15 nuk kane ofruar prova për trashëgimin e tyre. Fakti se paraardhësit e tyre kane vdekur nuk është e mjaftueshme për te vërtetuar se kush ishin trashëgimtarët e ligjshëm për pasurinë e te ndjerit. Prova e propozuar nuk lidhet me të, certifikatat e vdekjes nuk janë aktvendime mbi trashëgiminë. Kështu qe, paditësit nuk kane arritur qe te vërtetojnë legjitimitetin e tyre aktiv. Prandaj padite e tyre janë te papranueshme”.

67. Lidhur me parashtruesin Ahmet Hoti, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme përmes Aktgjykimit [SCC-11-0289] të 24 janarit 2017, kishte theksuar si në vijim:

Padia e paditësit numër 3 është e pabazuar. Paditësi nuk ka qene mjaftueshëm konkret lidhur me vendndodhjen e tokës ne fjalë, të pretenduar të shpronësuar, nga ai. Vendimi që paditësit i janë referuar nuk është parashtruar ne gjykate. Pasi qe aty nuk pasur asnjë pretendim të vërtetuar lidhur me shpronësimin e pretenduar me force, nuk ishte e mundur qe të merren prova lidhur me këtë. Referimi i përgjithshëm i situatës ne atë kohë apo lidhur me atë se çfarë ka mund te ketë ndodhur me te tjerët, nuk është e mjaftueshme për te vërtetuar se çfarë ka ndodhur me këtë paditës.

Gjykata nuk ka pasur nevojë qe te marre prova ne lidhje me vendndodhjen e shpronësimit të paditësit, sepse procedura e provave nuk ka funksionin për të lejuar paditësin qe te ndryshoj pretendimet e tij. Procedura e provave ka funksionin për te përcaktuar se çka është e drejte e çka e gabuar lidhur me pretendimet e kontestuar rreth fakteve relevante. Pa pretendime të mjaftueshme konkrete, nuk ka nevojë qe te merren prova. Gjykata gjithashtu nuk ka pasur nevojë për dëgjimin e paditësit. Se pari ligji lejon qe pala mund t'i drejtohet gjykatës vetëm nëse gjykata vendos qe t'i parashtroje atij pyetje, dhe gjykata nuk kishte asnjë arsye qe ta bënte këtë, pasi nuk kishte asnjë pengese qe përfaqësuesi te flas. Ka qene detyrë e tij qe te jetë i përgatitur. Se dyti, paditësi nuk është paraqitur ne seance e cila ishte planifikuar dy muaj me pare dhe asnjë justifikim për mungesë te tij nuk është paraqitur në gjykate.

68. Duke adresuar pretendimet e njëjta, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përmes Aktgjykimit [AC-I-17-0048] të 11 marsit 2021, kishte dhënë arsyet e refuzimit të ankesës së parashtruesve Gani Hoti, Emin Mehmet Hoti (përfaqësuar para Gjykatës nga Xhevat dhe Nexhat Hoti), Bajram Hoti, Elmi Hoti, Fehmi Hoti, Sokol Hoti, Musli Hoti, Vehbi Hoti, Ukshin Hoti, Kadri Hoti dhe Smajl Hoti , duke theksuar si në vijim:

“Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit te Specializuar është i sakte ne rezultat dhe ne arsyetimin ligjor, andaj ai duhet te vëletohet.

Lidhur me paditësit nën nr. rendor 5 deri 15, në rast të një padie në lidhje me të drejtat mbi një pasuri të trashëguar, Gjykata duhet të shqyrtojë ex officio nëse të gjithë trashëgimtarët janë të përfaqësuar. Aktvendimi i Trashëgimisë është dokument i vetëm për të treguar dëshmuar ne mënyrë te mjaftueshme pozitën trashëgimore dhe duhet te kërkohet nga paditësit sa me pare qe lind ndonjë dyshim se jo te gjithë trashëgimtarët janë të përfaqësuar si paditës për rastin në fjalë. Nëse Aktvendimi i trashëgimisë~ nuk është paraqitur brenda afatit te arsyeshëm, padia duhet hedhur poshtë si e papranueshme. Legjitimiteti aktiv i paditësit megjithatë është kundërshtuar, legjitimiteti aktiv duhet te shqyrtohet menjëherë sepse kjo do te jete një humbje e kohës dhe burimeve qe te shkoje me tej për aq kohe sa nuk është e qarte nëse paditësi mund te jete bartës i se drejtës qe ai e pretendon. Nëse ai nuk mund te jete bartës i se drejtës te cilën e pretendon

atëherë padia duhet te hedhet poshtë si e pa pranueshme. Ne këtë lëndë Kolegji i Apelit vëren se paditësit nuk kanë rregulluar çështjen e trashëgimisë. Paditësit i është dhënë mundësia nga ana e gjykatës, përmes ne seancën dëgjimore të datës , 14/11/2016 te dërgoje Aktvendimin e trashëgimisë për te vërtetuar legjitimitetin e tyre aktiv, mirëpo kanë dështuar ta dorëzojnë këtë dokument. Kolegji i Apelit vlerëson se Aktvendimi Trashëgimisë është i vetmi dokument ne baze te nenit 171.1 lidhur me. nenin 178.1 te Ligjit për procedurën jo kontestimore, i cili e vërteton legjitimitetin e aktiv ne procedurë. Ne baze te arsyeve te cekura ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet, Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit te Specializuar te DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar ne ligj.

69. Po ashtu, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përmes Aktgjykimit [AC-I-17-0048] të 11 marsit 2021, kishte dhënë arsyet e refuzimit të ankesës së parashtruesit Ahmet Hoti, duke theksuar si në vijim:

“ [...] Lidhur me paditësin nr. 3, Kolegji i Apelit konsideron se ne baze te nenit 42.3 te Ligjit, palët kane për detyre te paraqesin te gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe te provoj faktet e pohuara, për ti mbështetur pretendimet e veta.

Ne këtë lende, vet paditësi theksoi se atij ia mohoi te drejtën pushteti i atëhershëm ne fuqi dhe prona e kontestuar ishte marre ne posedim te Koperativës Bujqësore ne mënyrë që të zbatohet politika e kolektivizmit të tokave të regjimit komunist. Nga kjo bëhet e qartë se paditësi është në dijeni të arsyeve se përse bartja e pronësisë veçse ishte regjistruar në regjistrat kadastral ne vitin 1959 dhe ndryshimi në posedim kanë ndodhur. Prandaj i mbetet atij që të deklaroj se përse nuk ishin te vlefshlune këto veprime dhe nuk mund të adresoheshin më herët parregullsitë.

Paditësi ka dështuar të sjellë shpjegime apo prova për të kundërshtuar vlefshmërinë ligjore të bazës mbi të cilën në vitin 1959, prona e pretenduar sipas historiatit të pronës nr.04/1986 të datës 30/04/2002 të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Klinë ka kaluar në emër të NSH-së.

Paditësi deri ne vitin 2011, kur e ka dorëzuar padinë e pare ne DHPKS nuk ka sjelle asnjë prove me te cilën do te dëshmonte se ndonjëherë e ka kontestuar ,ligjshmërinë e ndryshimeve kadastrale lidhur me këtë prone [...]”.

70. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, në rrethanat e rastit konkret, kishin trajtuar dhe arsyetuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës, dhe se Gjykata vëren se të dyja gjykatat kishin konstatuar se sa i përket parashtruesve të kërkesës E.H, R.H dhe V.H (të cilët nuk janë parashtrues para Gjykatës), padia e tyre ishte refuzuar për shkak se përfaqësuesi i tyre nuk kishte sjell autorizimet për përfaqësim edhe për kundër kërkesës së gjykatës. Ndërsa sa i përket parashtruesve te kërkesës aktuale, gjykatat kishin konstatuar se “ne rast te një padie ne lidhje me te drejtat mbi një pasuri te trashëguar” parashtruesit nuk kishin dëshmuar me asnjë provë me të cilën do vërtetohej se mund te jete bartës i se drejtës te cilën e pretendon respektivisht patundshmërisë kontestuese. Rrjedhimisht, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së kishin theksuar se parashtruesit it nuk kanë dëshmuar se kanë legjitimitet aktivë. Për sa i përket parashtruesit të kërkesës Ahmet Hoti, gjykatat padinë e tij e kishin refuzuar si të pabazuar me arsyetimin se nuk kishte arrite te përcaktoj saktë vendndodhjen e patundshmërisë së pretenduar; se kishte qene i njoftuar për arsyet e konfiskimit dhe nuk ka arrite te “deklaroj se përse nuk ishin te vlefshlune këto veprime dhe nuk mund të adresoheshin më herët parregullsitë”; se nuk ishte parashtruar asnjë prove se shpronësimi kishte ndodhur me forcë, si dhe

“nuk ka sjelle asnjë prove me te cilën do te dëshmonte se ndonjëherë e ka kontestuar, ligjshmërinë e ndryshimeve kadastrale lidhur me këtë prone”.

71. Nga si me sipër Gjykata vëren se Kolegji i Apelit të DHPGJS ka vlerësuar interpretimin e Kolegjit të Specializuar sa i përket dispozitave procedurale në lidhje me legjitimitetin aktiv të parashtrueseve. Kolegji i Apelit gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtrueseve të kërkesës arsyetoi se Kolegji i Specializuar me të drejtë ka hedhur poshtë padinë e parashtruesit, pasi parashtruesi nuk ka dorëzuar aktvendimin e trashëgimisë për të dëshmuar legjitimitetin aktiv në lidhje me parcelat e kontestuar.
72. Gjykata rikujton se Kolegji i Apelit, refuzoi ankesën e parashtruesve kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar për arsye procedurale, pasi që parashtruesit nuk kishin dorëzuar aktvendimin e trashëgimisë për të dëshmuar legjitimitetin e tyre aktiv, ndërsa padinë e parashtruesit Ahmet Hoti, gjykatat e kishin refuzuar si të pabazuara me arsyetimin se nuk kishte *“nuk ka sjelle asnjë prove me te cilën do te dëshmonte se ndonjëherë e ka kontestuar, ligjshmërinë e ndryshimeve kadastrale lidhur me këtë prone”*. Gjykata vëren se në lidhje me kërkesën për njohjen e të drejtës në prone dhe kthimin e parcelave të kontestuara gjykatat e rregullta nuk e kanë trajtuar në mënyrë specifike vet esencën e kërkesës së parashtrueseve, (Shih rastin e Gjykatës KI101/19, parashtrues Ljubisa Trajkovic, Aktvendim për Papranueshmëri i 4 dhjetorit 2020, paragrafi 49, shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI104/17 me parashtrues Naser Berisha, Aktvendim për Papranueshmëri i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 33).
73. Prandaj, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ata, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta e të shtjelluara më lart, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk dëshmojnë dhe nuk mbështesin në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre, dhe rrjedhimisht pretendimet e tyre kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e *“shkallës së katërt”* dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të *“ligjshmërisë”* dhe nuk janë argumentuar në nivel të *“kushtetutshmërisë”*. Për pasojë, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
74. Sa i përket pretendimit të mos dëgjimit të palëve dhe dëshmitarëve të propozuar, Gjykata vëren se me Aktgjykimin[SCC-11-0289] e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së të 24 janarit 2017, është arsyetuar si në vijim: *“Gjykata gjithashtu nuk ka pasur nevojë për dëgjimin e paditësit. Se pari ligji lejon që pala mund t'i drejtohet gjykatës vetëm nëse gjykata vendos që t'i parashtrojë atij pyetje, dhe gjykata nuk kishte asnjë arsye që ta bënte këtë, pasi nuk kishte asnjë pengesë që përfaqësuesi të flasë. Ka qenë detyrë e tij që të jete i përgatitur. Se dyti, paditësi nuk është paraqitur në seancë e cila ishte planifikuar dy muaj më parë dhe asnjë justifikim për mungesë të tij nuk është paraqitur në gjykatë”*. Me këtë Gjykata konsideron se në tërësinë e tyre, procedurat para Gjykatave të rregullta, nuk rezultojnë të kenë qenë të padrejta apo arbitrare.
75. Në këtë aspekt, Gjykata vëren që dy seanca ishin mbajtur në gjykatën e shkallës së parë, njëra më 14 nëntor 2016 dhe tjetra më 16 janar 2017, ku në të cilat kishte marrë pjesë përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës, gjë e cila theksohet në aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së *“ përfaqësuesi i paditësve në seancën e dytë dëgjimore ka sugjeruar që palët të dëgjohen personalisht në lidhje me rrethanat e shpronësimit të tokës në fjalë dhe dëshmitarët e propozuar për të vërtetuar përdorimin e papenguar të tokës nga ana e paditësve. Megjithatë asnjë nga paditësit nuk u paraqit në seancë, e cila ishte planifikuar dy muaj më parë”*.

76. Gjykata vëren se seanca dëgjimore nuk ishte mbajtur pranë Kolegjit të Apelit, sepse Kolegji përkatës kishte vendosur mbi bazën e autorizimeve të dala nga Ligji për DHPGJS që të mos mbaj seancë dëgjimore. Ky Kolegj kishte vendosur mbi bazën e ankesës dhe përgjigjes në ankesë, që të vërtetohet Aktgjykimi [SCC-11-0289] i 24 janarit 2017 i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së.
77. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, për të theksuar që e drejta në seancë dëgjimore në procedurën ankimore nuk është absolute. Në parim, në rast se një e tillë është mbajtur në gjykatën e shkallës së parë, në procedurën e apelit, një e tillë nuk kërkohet detyrimisht (shih rastin e Gjykatës KI143/16, parashtues Muharrem Blaku dh të tjerët, Aktvendim për Papranueshmëri i 8 qershorit 2018, paragrafi 49).
78. Gjykata rithekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI118/17 parashtues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2018, paragrafi 36; KI49/19, cituar më lart, paragrafi 54; dhe KI99/19, parashtuese *Persa Raičević*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 48).
79. Andaj, edhe përkitazi me këtë pretendim, Gjykata konsideron se parashtuesit e kërkesës thjeshtë janë të pakënaqur me rezultatin e procedurës pranë Kolegjeve të DHPGJS-së; andaj pakënaqësia e tyre nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, aplikimi nr.5503/02 Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
80. Nga si më lart, Gjykata këtë pretendim të parashtuesve të kërkesës e konsideron si pretendim që kategorizohet me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes” dhe rrjedhimisht të njëjtin e konsideron qartazi të pabazuar, në baza kushtetuese.

Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

81. Sa i përket pretendimit për shkelje të së drejtës së pronës, Gjykata rikujton se parashtuesit e kërkesës theksojnë: *“prona që është objekt i kërkesës është marre me konfiskim dhe se të njëjtit janë privuar nga e drejta e kësaj prone të paluajtshme me dhunën e instrumentalizuar nga pushteti komunist jugosllavë”*.
82. Tutje, parashtuesit shtojnë se: *“është i natyrës arbitrare dhe abuzive konstatimi i aktgjykimit të gjykatës se shkallës së parë se prona e pretenduar është prone shoqërore, pa e konkretizuar, pa administruar asnjë prove dhe pa shqyrtuar asnjë fakt se ku gjendet ajo prone, sipërfaqe, vendndodhje dhe elementet e tjera të përkufizimeve dhe matjeve gjeometrike*.
83. Gjykata rikujton se ankesat e parashtuesve të kërkesës Gani Hoti, Emin Hoti (Xhevat dhe Nexhat Hoti), Bajram Hoti, Elmi Hoti, Fehmi Hoti, Sokol Hoti, Musli Hoti, Vehbi Hoti, Ukshin Hoti, Kadri Hoti dhe Smajl Hoti, u refuzuan nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së për arsye se: *“Paditësve i është dhënë mundësia nga ana e gjykatës, përmes në seancën dëgjimore të datës 14/11/2016 të dërgojnë Aktvendimin e trashëgimisë për të vërtetuar legjitimitetin e tyre aktiv, mirëpo kanë dështuar ta dorëzojnë këtë dokument. Kolegji i Apelit vlerëson se Aktvendimi Trashëgimisë është i vetmi dokument në bazë të nenit 171.1 lidhur me. nenin 178.1 të Ligjit për*

procedurën jo kontestimore, i cili e vërteton legjitimitetin e aktiv në procedurë. Në bazë të arsyeve të cekura ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet, Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.”.

84. Krejt në fund, Kolegji i Apelit, sa i përket parashtruesit Ahmet Hotit, arsyeton se: *“Lidhur me paditësin nr. 3, Kolegji i Apelit konsideron se në bazë të nenit 42.3 të Ligjit, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të provoj faktet e pohuara, për ti mbështetur pretendimet e veta. Paditësi ka dështuar të sjellë shpjegime apo prova për të kundërshtuar vlefshmërinë ligjore të bazës mbi të cilën në vitin 1959, prona e pretenduar sipas historiatit të pronës nr.04/1986 të datës 30/04/2002 të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Klinë ka kaluar në emër të NSH-së”.*
85. Nga si më sipër, Gjykata konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk kemi të bëjmë me një të drejtë pronësore të fituar me një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe as me pritje legjitime, sepse parashtruesit e kërkesës nuk kanë një të drejtë të pohueshme me të cilën dëshmojnë dhe provojnë se ata e kanë të drejtën e pronës mbi paluajtshmërinë në fjalë. (shih, ngjashëm, GjEDNJ rasti *Kopecký kundër Sllovakisë* [DHM], parimet e paraqitura në paragrafin 52). Andaj, në këto rrethana, parashtruesit e kërkesës nuk mund të pretendojë shkelje të të drejtave pronësore, përderisa Kolegjet e DHPGJS-së, në rastin e tyre shqyrtuan vetëm aspektet procedurale të padisë/ankesës së tyre, përkitazi me kërkesat për vërtetimin dhe dorëzimin në posedim dhe shfrytëzim të patundshmërisë kontestuese.
86. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se ajo vet nuk mund të shndërrohet në gjykatë të faktit dhe të vendosë për njohjen ose vërtetimin e pronësisë së një prone a pronave, sepse një kompetencë e tillë, si rregull, iu takon gjykatave të juridiksionit të rregullt ta bëjnë. Për më tepër, me asnjë vendim gjyqësor nuk konfirmohet se parashtruesit e kërkesës e kanë të drejtën e pronësisë mbi patundshmërinë kontestuese. Gjykata thekson se sa i përket të drejtave pronësore, ajo mund të ndërhyjë vetëm atëherë kur parashtruesve të kërkesave iu është njohur e drejta e pronësisë me një vendim gjyqësor përfundimtar ose me ligj dhe zbatimin e një të drejte të tillë të fituar nuk ka gjetur zbatim në praktikë tek autoritetet publike. (shih, më lart parimet e përgjithshme, gjetjet e GjEDNJ-së, paragrafi 74 i këtij dokumenti).
87. Po ashtu sa i përket çështjes së kthimit të pronës, Gjykata gjithashtu i referohet vendimeve kryesore të GjEDNJ-së në të cilat është diskutuar çështja e kthimit të pronës, aplikueshmëria e garancive të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së lidhur me kthimin e pronës, dhe obligimet që Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës (në tekstin e mëtejshëm: Shtetet Kontraktuese) kanë në këtë drejtim (shih, mes autoriteteve tjera, Aktgjykimin e GjEDNJ-së, të 4 marsit 2003, Jantner kundër Sllovakisë, nr. 39050/97, paragrafi 34; Aktgjykimin e GjEDNJ-së [DHM], të 10 korrikut 2002, Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke, nr. 39794/98, paragrafët 70-74).
88. Gjykata vëren se në vendimet e lartpërmendura të GjEDNJ-së, në paragrafët specifikë të cituar më lart, inter alia, thuhet që neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nuk mund të interpretohet sikur imponon obligime të përgjithshme mbi Shtetet Kontraktuese që të kthejnë pronën e cila iu është transferuar atyre para se të ratifikonin KEDNJ-në. Ky është parimi i parë bazë. Ky nen po ashtu nuk mund të interpretohet ashtu që i njëjti e kufizon lirinë e Shteteve Kontraktuese të përcaktojnë fushëveprimin e kthimit të pronës apo zgjedhjen e kushteve nën të cilat do të bëhet kthimi i pronës tek ish-pronarët. Ky është parimi i dytë bazë (shih Aktgjykimin e GjEDNJ-së, Jantner kundër Sllovakisë, cituar më lart, paragrafi 34).

89. Gjykata thekson se KEDNJ-ja dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së: (i) nuk i obligon Shtetet Kontraktuese që të nxjerrin një Ligj për kthimin e pronës; (ii) iu lejon Shteteve Kontraktuese liri të konsiderueshme në vendosjen dhe përcaktimin e fushëveprimit të kthimit të pronës dhe zgjedhjen e kushteve të aplikueshme për një gjë të tillë; (iii) iu mundëson Shteteve Kontraktuese të përcaktojnë ose përjashtojnë kategori të caktuara nga e drejta për kthim të pronës; dhe (iv) i obligon Shtetet Kontraktuese që, në rastet kur vet kanë vendosur që të nxjerrin ligj për kthimin e pronës, të respektojnë të drejtën për mbrojtje të pronës të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së meqë në raste të tilla mbrojtja nga ky nen është e drejtë e garantuar me KEDNJ. Këto janë katër parimet e përgjithshme lidhur me çështjen e “kthimit të pronës”, në bazë të KEDNJ-së dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, tashmë të konsoliduar në këtë drejtim (shih rastin KI71/19, parashtrues Avni Vula, cituar më lart, paragrafi 27).
90. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në Republikën e Kosovës nuk ka një ligj të veçantë për kthim të pronave dhe si rrjedhojë kërkesat për kthim të pronave nuk mund të bazohen në garancitë që i ofron neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së apo, mutatis mutandis, në garancitë e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës. Kjo, siç u shpjegua më lart, për arsye të vetme që kërkesat për kthim të pronave nuk mund të konsiderohen se përbëjnë një “pritje legjitime” përderisa nuk ekziston një ligj për kthim të pronave (shih rastin nr. KI78/18, parashtrues Pashk Malota, cituar më lart, paragrafi 53 dhe KI71/19, parashtrues Avni Vula, cituar më lart, paragrafi 28).
91. Andaj, edhe përkitazi me këtë pretendim, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës thjeshtë janë të pakënaqur me rezultatin e procedurës pranë Kolegjeve të DHPGJS-së, andaj pakënaqësia e tyre nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, aplikimi nr.5503/02 Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
92. Në këtë kontekst, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesve të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës në pronë të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së është qartazi i pabazuar nga arsyet e lartcekura.

Përkitazi me pretendimet tjera, respektivisht shkeljet e nenit 24 të Kushtetutës

93. Siç u cek më lart, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, shkel të drejtat e tyre të garantuara me nenin 24 të Kushtetutës. Mirëpo, parashtruesit e kërkesës vetëm e përmendin nenin respektiv, por nuk shtjellojnë më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtij neni përkatës të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese KI187/18 dhe KI 11/19, parashtrues: *Muhamet Idrizi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2019, paragrafi 73, KI125/19 parashtrues: *Ismajl Bajgora*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 63, dhe së fundmi rastin KI175/20, parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 26 marsit 2021, paragrafët 79-82).
94. Prandaj, Gjykata konstaton se përkitazi me këtë pretendim të parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 24, të Kushtetutës, Gjykata konkludon që kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e

pabazuar pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë (iii) pretendime “të pambështetura ose të paarsyeshme”, sepse parashtuesit e kërkesës thjesht cituan nenin 24 të Kushtetutës, pa shpjeguar se si ishte shkelur ai. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

95. Sa i përket parashtuesve të kërkesës Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti, Gjykata në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullit 39 (1) (a) të Rregullores së punës konstaton se parashtuesit e kërkesës Xhevat Hoti dhe Nexhat Hoti nuk janë palë e autorizuar, dhe se kërkesa e tyre nuk i plotëson kriteret e parapara në nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës.
96. Sa i përket pretendimeve të parashtuesve të kërkesës Ahmet Hoti, Gani Hoti, Bajram Hoti, Elmi Hoti, Fehmi Hoti, Sokol Hoti, Musli Hoti, Vehbi Hoti, Ukshin Hoti, Kadri Hoti, Smajl Hoti, Gjykata konkludon se kërkesa e tyre duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, dhe atë: i) përkitazi me pretendimet në lidhje me nenin 31 kërkesa është qartazi e pa bazuar për shkak se pretendimet e tyre kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë (i) pretendime të “*shkalles së katërt*”; ii) përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 46 kërkesa është qartazi e pabazuar për shkak se pretendimet e tyre kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë (ii) “*mungesë evidente /te dukshëm te shkeljes*”; iii) përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 24 kërkesa është qartazi e pabazuar për shkak se pretendimet e tyre kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë (iii) pretendime “*të pambështetura ose paarsyetuara*”.
97. Rrjedhimisht Gjykata vjen në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.

Kërkesë për Seancë Dëgjimore

98. Gjykata vëren se parashtuesit e kërkesës kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore.
99. Përfaqësuesi i parashtuesve të kërkesës lidhur me kërkesën për seancë dëgjimore arsyeton si në vijim: “*të më thërras për të më mundësuar të marrë pjesë dhe për të shqyrtuar në seancën dëgjimore*”.
100. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rregullit 42 (1) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“Vetëm kërkesat e përcaktuara si të pranueshme mund të dëgjohen para Gjykatës, përveç nëse Gjykata, me shumicë votash, vendos ndryshe pas një arsytimi të mirë”.
101. Siç është konkluduar më parë, kërkesa e parashtuesve të kërkesës shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar, prandaj edhe kërkesa e parashtuesve të kërkesës për seancë dëgjimore duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (1) dhe (2), 42 (1) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 22 qershor 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për seancë dëgjimore;
- III. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Remzie Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Esra Caka Nimani